217/20

30.03.2020

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VUSHTRRISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr i Prokurimit	**VU644-19-7674-2-2-1**
Nr i brendshëm	**VU644-19-122-221**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.SH. MVR Elektromontues
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Hajvali p.n.
(Adresa)

Prishtinë *(Vendi)* — **10000** *(Kodi postar)*

049 277 887 *(Numri Telefonit)* — *(Numri i Faks-it)*

Shukri Vitija
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

mvr-el@hotmail.com
(Adresa elektronike)

30.03.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës)

N.SH. ELEKTROMONTUES M.V.R. HAJVALI-PRISHTINË

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: "**Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra".**

Njoftimi për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit është bërë më datë 09.10.2019.
Hapja publike është bërë me datë 28.10.2019.
Njoftimi për Vendimin e AK dhe njoftimi për eliminimi na është dërguar me datë 24.12.2019.
Të pakënaqur me vendimin e AK dhe në afat të rregullt kohorë kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK.
AK me datë 06.01.2020 na kthen përgjigje duke e refuzuar kërkesën tonë andaj të pakënaqur me këtë vendim dhe në afat të rregullt kohor iu kemi drejtuar OSHP-se me ankesë e cila me pas lenden e ka kthyer ne ri-vlerësim.

Pas ri-vlerësimit nga ana e AK-së ne prapë jemi eliminuar padrejtësisht nga konkurrenca dhe te pakënaqur me vendimin e AK-se si dhe ne afat te rregullt kohorë kemi parashtruar

Kërkesë për Rishqyrtim.
Me datë 19.03.2020 në ora 16.10 AK ka ngarkuar në e-prokurim vendimin mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim.
Të pakënaqur me vendimin e AK-se për refuzimin e kërkesës tonë si dhe ne afat te rregullt kohorë parashtrojmë Ankesë pran OSHP-së

Kriteri i vlerësimit ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët me poentim.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja publike është bërë me datë 28.10.2019. Në procesverbalin e hapjes publike nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Me datë 16.03.2019 kemi parashtruar për herën e dytë Kërkesë për Rishqyrtim pran AK ndërsa këta të fundit me datën 19.03.2020 në ora 16.10 na kanë kthyer përgjigje duke na e refuzuar kërkesën tonë si të pabazuar.
Të pakënaqur me këtë vendim dhe në afat të rregullt kohor i drejtohemi për herën e dytë OSHP-së me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë zhvillimit te kësaj procedure ka shkelur këto dispozita të LPP dhe RUOPP.

1. **AK ka shkelur nenin 7 të LPP të amandamentuar,**
2. **AK ka shkelur nenit 52 të LPP të amandamentuar,**
3. **AK ka shkelur nenit 59 të LPP të amandamentuar,**
4. **AK ka shkelur nenit 60 të LPP të amandamentuar,**
5. **AK ka shkelur nenit 61 të LPP të amandamentuar,**
6. **AK ka shkelur nenit 72 të LPP të amandamentuar,**
7. **AK ka shkelur Rregulloren B57 lidhur me trajtimin e çmimeve jo-normalisht te ulëta.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së gjatë ri-vlerësimit të ofertave pasi që gjatë këtij procesi na ka diskriminuar duke na eliminuar prapë nga konkurrenca për një arsye apo mangësi që njëjtë sikur se ne e posedon edhe OE i shpallur fitues. Fjala është për çmimet jo-normalisht të ulëta nëpër pozicione ku edhe pas kërkesës për sqarim dhe ofrimit të sqarimeve tona herën e parë të vlerësimit, AK prapë na eliminon si të papërgjegjshëm. Përpos sqarimeve të ofruara, ne kemi ofruar disa mundësi që AK të jetë i siguruar se të gjitha pozicionet e tilla do ti realizojmë sipas ofertës. Kemi shkuar deri aty sa kemi ofruar edhe mundësi të liferimit të menjëhershëm të artikujve, rritje të garancionit të ekzekutimit si dhe çdo mundësi tjetër që AK të jetë i siguruar se ne do ta kryejmë kontratën në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Diskriminimi tjetër është se AK ia ka rritur garancionin e ekzekutimit OE që e ka shpallur fitues që do të thotë se vet AK e ka pranuar se edhe ai ka çmime jo-normalisht të ulëta dhe

ka frigë se nuk do mundet ta realizoj kontratën. Bazuar në këtë AK është dashur që këtë mundësi të na e ofroj neve sepse kemi çmimin më të ulët në krahasim me OE që Ak e ka shpallur fitues.

AK e favorizon haptazi OE të shpallur fitues ku edhe pas sqarimeve të ofruara nga ai shihet qartë se kemi gjendjen e njëjtë sa i përket çmimeve që AK na i trajton si jo-normalisht të ulëta. Sqarimet tona i trajton si të pa arsyeshme ndërsa ato të OE që e ka shpallur fitues i merr si të arsyeshme edhe pse në fakt janë shumë më pak bindëse se ato që ne kemi ofruar. Këtë e vërteton edhe rritja e garancionit të ekzekutimit.

Këtu shihet qartë se AK ka bërë trajtim jo të barabartë duke na diskriminuar neve dhe duke e favorizuar OE tjetër edhe pse ai kishte çmimin dy fish më të lartë se ne dhe kishte ofruar çmime shumë të ulëta në pozicione që nuk shkojnë fare ndërsa në pozicionet për të cilat dyshohet se OE ka informacione se përdoren më shumë ka vendosur çmime shumë më të larta se çmimet e tregut. Po që se i bëjmë një analizë ofertës tonë dhe asaj të OE të shpallur fitues shihet se AK po tenton të kontraktoj një ofertë që do ti kushtoj 2 here më shumë se sa oferta jonë.

Për të ju bindur se AK ka bërë trajtim jo të barabartë duke aplikuar vetëm ndaj nesh nenin 61 të LPP-së dhe Rregulloren për çmime jo-normalisht të ulëta – B57, po ju paraqesim disa nga çmimet jo-normalisht të ulëta të OE që AK e ka shpallur fitues. Ndaj OE që e ka shpallur fitues AK nuk e aplikon këto rregulla edhe pse deFAKTO e din që i ka çmimet e jo-normalisht të ulëta pasi që ja ka rritur garancionin e ekzekutimit:

Disa nga çmimet jo-normalisht të larta i gjeni në tabelën e më poshtme:

Kategoria	*Përshkrimi i shërbimeve/pozicioneve*	*Njësia Matëse*	*Sasia*	*Totali ime TVSH-€*	Cmimi i tregut
A	Kategoria A			(Kategoria A 70% e pikëve në vlersim)	
5	Furnizimi dhe montimi i poçave efiçiente 105W me E27 dhe E40	Copë	1.00	€ 1.00	€ 8.00
10	Porosia dhe montimi i relesë IC ASTRO Shnider,Siemens,ABB ose e ngjajshme ekuivalent.	Copë	1.00	€ 0.50	€ 65.00
13	Porosia dhe montimi i vazhduesve kabllovik (muf) me dim. 50, 25, dhe 16mm²	Copë	1.00	€ 0.50	€ 15.00
19	Furnizimi dhe montimi i shtyllave metalike të galvanizuara(pa lirë), për montim në sheshet e qytetit, të ngjajshme me ato ekzistueset per nga dizajni dhe përmasat.	Copë	1.00	€ 8.50	€ 120.00
21	Porosia furnizimi dhe montimi i siguresave thikore 160A të vendosura në trafo për furnizim të ornamëve	Copë	1.00	€ 0.10	€ 4.00
23	Furnizimi dhe montimi i pllakave Aradit RP4 me siguresë FRA 16A.	Copë	1.00	€ 0.50	€ 17.00

B	**Kategoria B**			**(Kategoria B 20% e pikëve në vlersim)**	
3	Porosia dhe montimi i dyerve të ormanëve të ndriçimit publik . Vërejtje: vlenë vetëm për dyert e ormanëve të dëmtuar.	copë	1.00	€ 0.20	€ 23.00
4	Furnizimi dhe montimi I trupit ndriçues REMO 400 me gjashtë poça GX 53 për montim në shesh te njejta me ato ekzistuese	copë	1.00	€ 10.00	€ 55.00
5	Furnizimi dhe montimi I trupit ndriçues GINO 400 E27 te njejta me ato ekzistuese	copë	1.00	€ 6.50	€ 33.00
8	Punimi i bazamentit prej betonit MB 30 për shtylla të metalit me bulona dhe material tjetër të nevojshëm. (0.80x0.80x0.80)m. komplet.	copë	1.00	€ 0.50	€ 23.00
9	Furnizimi dhe montimi i shtyllës së betonit 9m, sipas porosisë së organit mbikqyrës	copë	1.00	€ 10.00	€ 110.00
12	Identifikimi i prishjes së kabllos me makinë speciale	copë	1.00	€ 0.10	€ 35.00
C	**Kategoria C**			**(Kategoria C10% e pikëve në vlersim)**	
10	Prerja, coptimi dhe largimi i asfaltit nga punishtja ne distance deri ne 15km dhe kthimi i asfaltit ne gjendjen e meparshme.Ne çmim te kalkulohet puna dhe materiali per gjatesi te kanalit	copë	1.00	€ 0.10	€ 100.00

Këto janë vetëm disa nga çmimet që shihet qartë se janë shumë jo-normalisht të ulëta ku në ofertën e OE që AK e ka shpallur fitues të tilla ka edhe shumë të tjera.

Ndërsa disa artikuj që ky OE ka informata se shkojnë më shumë kanë çmime jo-normalisht të larta siç janë:

A3– çmimi i tregut është 1 € ndërsa ky OE e ofron 3 €,

A6 – çmimi i tregut është 2 € ndërsa ky OE e ofron 4 €,

A10 – çmimi i tregut është 1 € ndërsa ky OE e ofron 3.9 €,

A12 – çmimi i tregut është 1 € ndërsa ky OE e ofron 4 €,

Pra po shihet qartë se ky OE ka ofruar çmime manipulative dhe oferta e tij në krahasim me tonën për nga çmimet njësi është dy fish më e lartë ndërsa për nga realizimi jemi të bindur se do del diku për 2 herë më e shtrenjtë se sa oferta jonë.

Prandaj me plot kuptim mund të themi se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP sepse nuk i ka trajtuar OE njësoj si dhe ka shkelur edhe nenin 61 të LPP-së dhe Rregulloren

B57 që nuk e ka trajtuar edhe çmimet e këtij OE si jo-normalisht të ulëta.

Kjo konsiderohet shkelje e plotë e nenit 7 të LPP-së për trajtim aspak të barabartë të OE ku si fakte mundeni të i shikoni listat e çmimeve dhe sqarimet e ofruara nga ne dhe OE i shpallur fitues e që në fakt janë identike.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenit 52 të LPP-së pasi që nuk e ka zbatuar si duhet dhe nuk e respektuar kriterin e vlerësimit të cilin e ka vendosur paraprakisht në dosjen e tenderit. Sipas këtij neni, kriteri i vlerësimit i vendosur me kohe në dosjen e tenderit duhet të respektohet gjatë vlerësimit të ofertave. Këtë nuk e ka bërë AK me rastin e kriterin çmimi më i ulët me poentim por ka vlerësuar sikur të ishte tenderi me kriterin "**Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**. Me që për çdo njësi OE marrin poenë të caktuar dhe në fund bazuar në ta edhe shpallet fituesi, trajtimi i çmimeve si normalisht të ulëta është joligjore dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së ku në të njëjtën kohë konsiderohet si shkelje e nenit 52 të LPP-së. Së shpejti ne do marrim edhe interpretim zyrtarë lidhur me këtë çështje andaj do të bindeni edhe vet se veprimi i juaj është në kundërshtim me LPP-në dhe praktikat e mira të prokurimit për rastin e aplikimit të kriterit të vlerësimit "**Tenderi i përgjegjshëm e çmimin më të ulët me poentim**".

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenit 59 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit nuk e ka respektuar nenin 59.4 i cili i kërkon AK që vlerësimi të bëhet bazuar vetëm në kërkesat e dosjes së tenderit. Pavarësisht asaj që ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat, këta të fundit na konsiderojnë të papërgjegjshëm duke mos e respektuar fare paragrafin 4 të këtij neni dhe duke mos respektuar kërkesat e dosjes së tenderit. Përpos kësaj shihet qartë se AK nuk ka respektuar as kriterin e vendosur nga vet ata në dosjen e tenderit sepse ne kemi pasur çmimin më të ulët të poentuar. Në rastet kur kriteri i vlerësimit është çmimi për njësi me poentim atëherë e hup kuptimin krahasimi i çmimeve për njësi por hyn në punë krahasimi i poenëve dhe trajtimi i çmimeve jo-normalisht të ulëta nuk vlen më. Pikërisht për këtë arsye AK ka vendosur poenë tek çmimet njësi me të vetmin qëllim për ti ikur rrezikut që OE manipulojnë me çmime. Me vet faktin që kriteri është tenderi me çmimin njësi me poentim, tregon që krahasimi i tenderëve bëhet sipas poenëve të fituar dhe çmimet për njësi e humbin efektin e vet. Kjo është e sqaruar shumë mirë tek RRUOPP që tregon se në rastet e tilla AK nuk mundet ta aplikoj nenin 61 të LPP-së dhe nuk mundet ta aplikoj as Rregulloren B57 për çmimet jo-normalisht të ulëta(shiko RRUOPP dhe sqarimet e KRPP-së). Këtë e tregon mirë nenin 18.28 i RRUOPP i cili tregon se ne rastet e tilla vlen çmimi i poentuar dhe çmimet e poentuara nuk mund te krahasohet me OE tjerë por edhe nuk ka logjik poenët te cilësohen jo-normalisht te ulet sepse pikërisht për te vlerësuar sa fiton poenë neper çmime njësi edhe vendosen. Nga kjo shihet qartë se AK ka shkelur nenin 59 lidhur me vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Thirrja në vendimin e OSHP është vetëm kamuflim i veprimeve antiligjore që po bënë AK tek ky tender pasi që shumë mirë i është kërkuar që lënda të ri-vlerësohet dhe atë vetëm sipas kërkesave të parashtruara paraprakisht në dosjen e tenderit

Pretendimi 4: AK ka shkelur nenit 60 të LPP-së pasi që nuk e ka aplikuar drejt kriterin e vlerësimit. Edhe pse ne kemi pasur çmimin më të ulët se OE i shpallur fitues e po ashtu edhe me poentimin e çmimeve kemi dalur të parët, AK nuk na shpall fitues duke aplikuar gabimisht nenin 61 të LPP, nenin 18,20 të RRUOPP dhe rregulloren B57 për çmimet jo-normalisht të ulëta. Nga kjo shihet qartë se AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së me rastin e përzgjedhjes së fituesit duke mos e respektuar kriterin e përcaktuar paraprakisht në dosjen e

tenderit.

Pretendimi 5: AK ka shkelur nenit 61 të LPP-së, nenin 18.20 të RRUOPP dhe Rregulloren B57 sepse këto nene dhe rregullore nuk aplikohen tek rasti kur kemi çmimet për njësi me poentim. Bazuar ne nenin 18,28 të RRUOPP i cili thotë:

18.28 Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, ***kontratat me çmime për njësi***, AK duhet te përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" ose "grup te artikujve" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët ne baze te poentimit, **si p.sh. mirëmbajtje te veturave, mirëmbajtje te gjeneratorëve etj.**

Sa për informim po ju japim një rast se si i ka trajtuar vet OSHP-ja rastet e tilla kur AK tek kriteri **Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët me poentim** e aplikon nenin 61 të LPP-së, nenin 18.20 të RRUOPP dhe Rregulloren B75. Në rast nevoje mundemi me ju tregu më saktë edhe shumë raste të tilla të trajtimeve të rasteve të ngjashme nga OSHP.(tek ky rast i marrur si precedent, nuk përputhen numrat e neneve sepse ka ndryshuar rregullorja dhe udhëzuesi por kuptimi është i njëjti). Në rastin e fundit OSHP ka shkelur edhe vet LPP-së dhe ka thyer konsistencën e veprimeve te veta për rastet e tilla. Arsyeja pse ka ndodhur kjo nuk dihet mirëpo kur me dhjetëra raste ngjashme i ka sanksionuar, pse u dashka që rasti i Komunës së Vushtrrisë të favorizohet duke vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit. Edhe pse ekspertiza e ESH-së dhe vendimi i OSHP në brendi kishin refuzuar pretendimin tonë në formën më të paqartë të mundshëm, vendimi përfundimtarë është që ri-vlerësimi të bëhet vetëm sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe kërkesave të LPP-së. Kjo nënkupton se përgjegjësia bie mbi juve sepse po i trajtoni ofertat jo barabar duke na diskriminuar neve e duke e favorizuar OE tjetër që e ka ofertën identike të ngjashme me tonën. Po që se shikohet qartë shihet se me dhjetra çmime jo normalisht të ulëta i posedon edhe OE i shpallur fitues. Shihe një nga vendimet e OSHP për rastet e ngjashme:

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, ka konstatuar se ky aktiviteti i prokurimit nuk ka baze ligjore për anulim për vete faktin se ne dosje te tenderit konkretisht tek FDT neni 30.1 është përcaktuar qe kriter vlerësimit të jete tenderi i përgjegjshëm me çmim me te ulet me poentim te përshkruar sipas Aneksit nr.6 te dosjes se tenderit, ku ne ketë aneks për secilin pozicion janë përcaktuar poenet ku është vlerësuar se janë çmime abnormalisht te ulëta, kriteri i përcaktuar për vlerësim minimizon mundësin e çmimeve abnormalisht te ulëta apo edhe te mbivlerësuara për arsye se varësisht prej çmimit dhe peshës qe i është dhenë atij pozicioni rezultojnë piket, ku ne baze te kësaj ne asnjë mënyrë nuk do te thotë se oferta e cila ka rezultuar me çmim me te ulet ne hapje mund te jete fituese e tenderit apo ne te kundërtën oferta me çmim me te lart mund te eliminohet pasi qe për secilin pozicion vlerësohen piket nga numri i poenëve te fituara kualifikohen operatoret ekonomik pjesëmarrës ne tender.

Lidhur me arsyen e eliminimit ne rastrin konkret për shkak se çmimet janë konsideruar jo normalisht te ulëta, paneli shqyrtues ka konstatuar se kjo pike nuk mund te jete baze për eliminim, sepse autoriteti kontraktues

ka detyrim ligjor qe pas vlerësimit te ofertave ne baze te kritereve te përzgjedhjes te vazhdoj me vlerësim ne bazë të kriterit te përcaktuar për vlerësim , ne këto raste AK-ja është dashur ti respektoj kërkesat e nenit 52 paragrafi 7 te LPP-se. Sipas dosjes shihen se ne disa formular kalkulimet janë bere ne baze te peshës se përshkruar ne aneksin 6 te dosjes se tenderit mirëpo komisioni vlerësues nuk i ka përfshirë ne raport duke mos ofertuar ne përputhje me nenin 59 te LPP-se, ku është dashur qe vlerësimin ta beje ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara na dosjen e tenderit, po ashtu paneli shqyrtues ka konstatuar se poentimi nuk është bërë edhe pse secili pozicion ka qen i peshuar , ku sipas aneksit 6 është dashur te poentohen çmimet par njësi dhe cilido nga OE qe merr pike me se shumti atëherë mund te rekomandohet për kontrate, nëse oferta e tij përmbush kriteret e përzgjedhjes. Paneli shqyrtues gjithashtu shpjegon se gjate hartimit te dosjes dhe konstatimeve te ekspertit shqyrtues është konstatuar se AK ju ka përmbajtur nenit 28.12 te Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (UOPP-se), ku del te kuptohet se çmimet përfundimisht mund te peshohen ne baze te rendesisë se secilës kategori te "shërbimeve" ose secilit "artikull" ne mënyrë qe Autoriteti Kontraktues te përcaktoj se cila është oferta e 0E-ve me çmim me te ulët. Prandaj ne raste te tilla, tenderuesi i cili ka dorëzuar çmimin me t ulei te kontratës mund te përcaktohet vetëm pasi te behet kalkulimet sipas Aneksit 6 te dosjes se tenderit, për shembull te rasti i kontratave kornizë kur kontrata përmban disa artikuj apo shërbime te shumëfishta, sasia e sakte nuk mund t llogaritet par zbatimit te kontratës. Ne këso raste AK do te vlerësoj frekuencën dhe rendësin e secilit artikull ose kategori te shërbimeve dhe do te peshoj çmimin ne baze te rendësish ku këtu pesha do te përdoren vetëm për qëllimin e artikulimit te rendësish se secilit shërbim apo artikull, dhe për te qene ne gjendje për te zgjedhur ofertën me çmimin me te ulet. Ne baze te nenit 28.13 te UOPP, çmimet e peshuara bazohen ne çmimin e ofruar nga Operatoret Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet qe te përcaktohen piket duke krahasuar çmimet e ofertuesve te ndryshëm. Funksioni i vetëm i peshimit te çmimit është qa te përcaktohet kontrata me çmimin ma te ulet, por pagesa gjithmonë kryhet ne baze te çmimit te ofertuar. Çmimi total i pa peshuar lexohet gjate procesit te hapjes se ofertave ashtu siç ka ndodhur me rastin e hapjes publike te ofertave.

Paneli shqyrtues vjen ne përfundim se ne ketë aktivitet te prokurimit nuk është respektuar neni 52 i LPP-se, dhe njëkohësisht nuk është bëre ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave konform nenit 59 te LPP-s.

Shihet qartë se në rastet e tilla nuk mundet të aplikohet kriteri i trajtimit të çmimeve jo-normalisht të ulëta. Nisur nga kjo shtrohet pyetja pse atëherë po poentohen çmimet?

Pas krejt këtyre sqarimeve shihet se AK ka shkelur nenin 61 të LPP, nenin 18.20 të RRUOPP dhe Rregulloren B57 të KRPP-së.

Pretendimi 6: AK ka shkelur nenit 72 të LPP-së pasi që edhe pas marrjes së sqarimit nga ana jonë i cili është shumë më bindës se sa sqarimi i ofruar nga konkurrenti te cilin AK e ka shpallur fitues, nuk i merr për bazë sqarimet tona dhe na eliminon nga konkurrenca për diçka të njëjtë që edhe konkurrenti jonë i posedon në ofertën e vetë. Me vet faktin që ne i kemi ofruar shumë mundësi për ta siguruar AK duke i kërkuar që ta rrit edhe garancionin e ekzekutimit tregon se sqarimet e ofruara nga ne janë bindëse dhe ligjërisht kemi plotësuar kërkesën e AK-së(*shihe të bashkangjitur sqarimin e ofruar nga ne*). Mos pranimi i sqarimeve tona si të rregullta dhe mos trajtimi i njëjtë e sqarimeve të ofruara edhe nga konkurrentët tonë e shtynë AK-në drejt shkeljes së nenit 7 të LPP-së mbi trajtimin e barabartë dhe e shtynë atë edhe drejt shkeljes së plotë të nenit 72 të LPP-së.

Pas gjithë këtyre sqarimeve, dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tonë kundër vendimit të AK-së dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar duke marr:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar ankesa e **OE "N.SH. MVR elektromontues"** lidhur me tenderin **"Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra".**

ANULOHET vendimi i AK – Kuvendi Komunal i Vushtrrisë dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësimi.
Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në detyrimet e AK ndaj LPP-së, RRUOPP-së dhe Rregullores B57 e që realisht më pas do duhej që **Fitues** te shpallej OE **"N.SH. M.V.R. ELEKTROMONTUES"**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, me një përvojë të madhe në këtë fushë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 1 B05 Njoftim per Kontrat
- 2 Dosja e Tenderit-Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra
- 3 Përshkrimi i çmimeve - Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra
- 4 2019-122 Proces verbali i hapjes se tenderit
- 5 B41-NSH MVR El. - kerkese per sqarime per qmime jonormalisht te uleta
- 6 Sqarimi i kerkeses se A - Deklarata e furnizusit, marrveshja e furnizimit
- 7 B58 - 2019 - 122 - vendimi i A.K. me dokumente shtese
- 8 59 interpretimi i KRPP
- 9 List a e cmimeve te OE TONI
- 10 Sqarimi nga OE TONI
- 11 Kërkesë për rishqyrtim - MVR ELEKTROMONTUES 30.12.2019
- 12 Vendim i A.K. per refuzimi te K.R. 06.01.2020
- 13 Ankesa - MVR ELEKTROMONTUES 15.01.2020
- 14 34-37-20 vendim i OSHP
- 15 B58 - 2019 - 122 - vendim i A.K. me dokumente shtese - pas Ri-vleresimit
- 16 Kërkesë për rishqyrtim - MVR ELEKTROMONTUES 16.03.2020
- 17 Refuzimi i KSH- pas Ri-vleresimit